



VENDIM

Nr. 87, Datë 07.06.2017

**MBI
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM
INTERNATIONAL” SH.A., NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME
ENERGJI ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “ç” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1 gërma “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për rinovimin e licencës për Shoqërinë “Kurum International” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatohet se:

ERE me Vendimin nr.69, datë 11.05.2017, filloi procedurën “Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike”.

Aplikimi i Shoqërisë “Kurum International” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “a.1”, “b.1” dhe “c.1”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Kurum International” sh.a në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,
VENDIMIN

Nr. 87, Datë 07.06.2017

MBI
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM
INTERNATIONAL” SH.A., NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME
ENERGJI ELEKTRIKE

An tar t e Bordit

	Pro	Kund r
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____